



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar Punimja/Prodato Received/Delivered	06.07.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKM/SHCK	5084/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.Nr.769/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: nga Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.769/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komunes së Skenderajt, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.769/2023 i datës 24.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi aplikues në konkursin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me numër RN00010440 për pozitën ‘*Zyrtar i Lart për Politika Rinore*’ në Komunën e Skenderajt, me datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net me numër protokoll 4392/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se ka pas shkelje ligjore në konkursin e lartë cekur .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.05.2023 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Komuna e Skenderajt për përgjigje në ankesë, ndërsa Këshilli më datë 26.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Skenderajt, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokoll 4392/2023 të datës 24.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga për ankesa.kpmshck@rks-gov.net 24.05.2023; SIMBNJ

dëshmi konkursi dhe dokumentet në pritje dhe verifikim paraprak; E-mail nga A.F. për simbnj.info i datës 19.05.2023; Përgjigje nga simbnj për ankuesin i datës 19.05.2023; Ankesë e ankuesit përmes e-mailit e datës 17.05.2023 drejtuar Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt; Të dhënat e shpalljes data njoftimit 23.11.2022; E-mail nga simbnj për A.F. i datës 15.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.05.2023; E-mail nga A.F. për C.Z. i datës 26.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.06.2023; E-mail nga M.R. për C.Z. i datës 29.06.2023; E-mail nga M.R. për C.Z. i datës 29.06.2023; E-mail nga M.R. për C.Z. i datës 29.06.2023; E-mail nga M.R. për S.A. etj. i datës 05.06.2023; Kërkesë nga NJMBNJ e Skenderajt me numër nr. 02-112/01-0055438/22 i datës 23.11.2022; Lista e aplikantëve; E-mail nga C.Z. për B.B. i datës 04.07.2023; E-mail nga F.Z. për C.Z. i datës 04.07.2023; E-mail nga B.B. për F.Z. i datës 04.07.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit

sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi ka aplikuar në konkursin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me numër RN00010440 për pozitën 'Zyrtar i Lart për Politika Rinore' në Komunën e Skenderajt. Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër mos përgjigjes nga Komuna e Skenderajt lidhur me aplikimin e tij në konkursin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me numër RN00010440 për pozitën 'Zyrtar i Lart për Politika Rinore'. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt me datë 23.11.2022 i është drejtuar me kërkesë DASHC që janë kompetent për menaxhimin e sistemit HRIMS të largoj nga sistemi (RN00010440) pasi që i njëjti është shpallur dy herë si shkak i një gabimi teknik dhe ne si NJMBNJ nuk mundemi të vazhdojmë tutje pasi që konkursi për pozitën 'Zyrtar i Lart për Politika Rinore' me RN00010471 është në proces të zhvillimit të procedurave. Këshilli përmes e-mailit me datë 04.07.2023 ka kërkuar sqarime nga DMZP se me cilën RN është zhvillu procedura e rekrutimit. Ndërsa bazuar në përgjigjen përmes e-mailit të datës 04.07.2023 nga Zyrtarja për administrimin e SIMBNJ-së në DASHC, konkursi tjetër me këtë RN00010471 është përfunduar procesi deri tek emërimi i kandidatit fitues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar me numër RN00010440 për pozitën 'Zyrtar i Lart për Politika Rinore' në komunën e Skenderajt, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 104 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë**, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.769/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

